



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 77

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 30 korrik 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Gëzim Kelmendi dhe Nazane Breca .

Munguan: Sasha Gjokiq, Bahri Thaçi, Liburn Aliu dhe Salihe Mustafa.

I ftuar : Nenad Rashiq, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;

Fikrim Damka, tha se në këtë takim kemi ftuar ministrin Rashiq që të diskutojmë amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian, të cilat amendamente përmbajnë implikime buxhetore. Fjalën ia kaloj ministrit Rashiq, që të jep vlerësimin e Ministrisë së Punës për këto amendamente.

Nenad Rashiq: “Ju falënderoj për ftesën dhe po e ceku se ky është një ligj shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës, por edhe për lidhjen e marrëveshjeve me shtete tjera për realizimin e pensioneve të qytetarëve tonë që punojnë jashtë Kosovës. Një ndër problemet e mosnënshkrimit të marrëveshjes me Zvicrën është mungesa e këtij Ligji.

Kur e kemi hartuar ligjin, kemi qenë shumë të kujdesshëm edhe lidhur me marrëveshjen që kemi me FMN-në dhe Bankën Botërore, që ka të bëjë me situatën financiare në Kosovë.

Sa i përket amendamentit 5, që ka të bëjë me stazhin e punës, që qytetari duhet ti ketë së paku 15 vjet stazh, kjo mendojmë se është adekuate për situatën në Kosovë, dhe mendojmë se duhet të mbetet si është në Projektligj”.

Amendamenti i propozuar nga Komisioni për Legjislacion po thirret në një ligj, që nuk është në fuqi në Kosovë. Edhe në ligjin e vjetër të RSAK, ka qenë kusht që duhet të ketë së paku 15 vjet përvojë pune. Ne jemi bazuar në disa standarde të domosdoshme.

Time Kadrijaj, tha se amendamenti i Komisionit për Legjislacion, thirret në ligjin e RSAK, si është e cekur në atë ligj, a kërkohet përvoja e punës prej 15 viteve apo jo?

Nenad Rashiq, theksoi se ne tani nuk mund ta inkorporojmë ligjin e vitit 1983, në ligjin tonë, edhe pse, po e ceku se edhe ne atë ligj parashihet 15 vjet përvojë pune duhet ti ketë qytetari, që të mund ta realizojë këtë të drejtë.

Nzane Breca, theksoi se ky ligj ka funksionuar deri para luftës, dhe Komisioni për Legjislacion është thirr në këtë ligj, sepse qytetarët e Kosovës kanë dhënë kontribute sipas atij ligji dhe për këtë arsye kanë të drejt t'i gëzojnë kontributet që i kanë paguar, aq vite sa kanë paguar.

Nenad Rashiq, tha se siç jeni të njoftuar, Kosova pas luftës ka ndryshuar sistemin e pensioneve dhe tani kemi tri shtylla, ndërsa ai fond ka ngelur në Serbi .

Flora Brovina, tha se siç e dimë, të gjithë gjatë viteve 90-të, shqiptaret janë larguar masivisht nga puna, prandaj si mund të numërohet ky stazh i punës?

Nenad Rashiq, tha se fillimisht duhet të bëjmë një ligj, pastaj do të bëhet kategorizimi i pensionistëve dhe njohja e stazhit të punës për punëtorët e larguar nga puna gjatë viteve të 90-ta.

Flora Brovina, pyeti se a do t'ju numërohet stazhi i punës edhe policëve dhe agjentëve të ardhur nga Serbia si masa të dhunshme ?

Nenad Rashiq: “ Të gjithë ata të cilët i plotësojnë kushtet ligjore, do ti marrin pensionet”.

Gëzim Kelmendi, tha se punëtorët e larguar nga puna gjatë viteve 90-të, janë diskriminuar nga ish- sistemi, tani edhe ne me këtë ligj ti diskriminojmë është e pa drejtë, dhe nuk guxojmë ta bëjmë këtë diskriminim, prandaj duhet ta gjejmë një zgjidhje që edhe ata të jenë pjesë e ligjit dhe ti marrin pensionet .

Fikrim Damka, tha se ulja e stazhit nga 15 vite në më pak vite, shkakton implikime buxhetore, dhe duhet të diskutohet me Ministrinë e Punës dhe Ministrinë e Financave .

Time Kadrijaj, tha se ndoshta duhet menduar që ky kusht të ulet së paku në 10 vite stazh pune, duke pas parasysh rrethanat që kanë qenë në Kosovë.

Gëzim Kelmendi, përsëriti edhe një herë, që periudha 1990-1999 duhet të llogaritet si periudhë kontributpaguese me këtë ligj, e jo me akt nënligjor.

Fikrim Damka, tha se pas diskutimeve që u bën, ky Projektligj edhe një herë duhet të diskutohet në grup punues dhe amendamentet e propozuara edhe një herë të shkojnë në Komisionin për Buxhet dhe mandej të procedohet Projektligji në seancë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka